



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.3102017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtarit ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendlodhi përkitazi lidhur me ankesën e Rrjetit Ballkanik të Gazetaris Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR-ALTERNATIVA, dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në afërsi të Qendrës së Votimit QV në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik i Gazetaris Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë dhe Koalicionit LDK-AKR-ALTERNATIVA i shqiptohet dënim i më gjybë në vlerë prej 2,500.00 (*dymij e pesëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12 Qershori 2017 nga Rrjeti Ballkanik i Gazetaris Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në Qendrën e Votimit QV, në shkollën “Shkenda” në Hajvali, kandidati për deputet të Kosovës nga radhët e Koalicionit LDK-AKR-ALTERNATIVA ka pasur poster të ngjitur në distancë më të vogël se 100 metra nga Qendra e Votimit. Nga këto veprime parashtruesi i ankesës ka theksuar se është shkelur LZP-ja.

Parashtruesi i ankesës, në cilësi të provës materiale si dëshmi, e ka bashkangjitur një CD .

PZAP-i, me datë 12.06.2017 i ka dërguar Kërkesë për Përgjigje në ankesë lidhur me ankesën Anr.310/2017 Koalicionit LDK-AKR-ALTERNATIVA, ndërsa Koalicioni në fjalë nuk është përgjigjur në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoj shkresat e lëndës, sipas nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së gjeti se :

Ankesa është e bazuar

Nga pretendimet ankimore si dhe nga prova materiale CD -ja e shiquar nga shkresat e lëndës është vërtetuar qartë se posteri i kandidatit për deputet Vesel Makolli nga radhët e Koalicionit LDK-AKR-ALTRNATIVA është vendosur në distancë më të vogël se 100 metra, pra në një objekt me ngjyrë të bardhë i gjendur kapur me oborrin e shkollës, "Shkenda", e njëjta Qendër e Votimit QV në Hajvali, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 36, pika a) dhe b) i LZP-së e cila përcakton: "Shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjëren nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfardo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit".

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase Koalicioni LDK-AKR-ALTERNATIVA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posteri i kandidatit për deputet nga ky Koalicion është vendosur në afërsi të Qendrës së Votimit. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që Koalicioni në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që nuk është përgjigjur në ankesë, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

Anr.310/2017 më datën 14.06.2017



Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.